



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

## NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

**Tema e konsultimit:** “Për hartimin e draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”

**Propozuesi i konsultimit:** Kryetari i Bashkisë / Koordinatori GMS-së / Sekretariati i Këshillit të Bashkisë / Drejtori i Financës dhe Buxhetit.

**Informacion për konsultimin:** Në fazën e parë të përgatitjes për hartimin e buxhetit afatmesëm 2023-2025, Bashkia Kukës fton të gjithë të interesuarit që janë banorë të Bashkisë dhe Njësive Administrative, të bëhen pjesë e diskutimit publik rreth hartimit të PBA-së dhe buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës, duke u angazhuar në përgjigjet e pyetjeve si më poshtë:

- A jeni ju të informuar mbi buxhetin e Bashkisë Kukës, shërbimet që kryhen me ndihmën e këtij buxheti dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve të Bashkisë Kukës?
- A jeni ju në dijeni se ka matës për treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin tuaj?
- A jeni ju në dijeni për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe buxhetit vjetor të Bashkisë Kukës, si një proces ligjor i domosdoshëm?
- A keni ju ndonjë opinion konkret në lidhje me mënyrën e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm nga Bashkia Kukës, hapat dhe fazat e këtij procesi?
- A keni ju një vlerësim për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara gjatë vitit financiar 2021?
- A jeni ju në dijeni për Raportin vjetor të performancës të Bashkisë Kukës dhe për Raportin periodik të monitorimit të zbatimit të buxhetit?
- A keni ju ndonjë rekomandim konkret tuajin apo të komunitetit që përfaqësoni, për prioritetet e investimeve kapitale për vitet 2023-2025?

- A ndjeheni ju të përfshirë në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe në procesin e monitorimit të buxhetit?

Vendi dhe koha e konsultimit: Konsultimi do të organizohet ditën e Hënë më datë 30.05.2022, ora 11<sup>00</sup> në sallën “Amerikan Corner” pranë Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina” Kukës.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët: Kryetari, zv Kryetarët, Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit Programeve, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Drejtues të njësive Administrative.

Nga të ftuarit: Drejtues të institucioneve qendrore e rajonale, përfaqësues të shoqërisë civile , organizatave jofitimprurëse, medias dhe biznesit, banorë të Bashkisë.

Forma e konsultimit: Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, në komisionet përkatëse dhe Këshillin e Bashkisë.

Me respekt,  
Kryetari i Bashkisë Kukës  
Safet GJICI



Konceptoi:

Malir IMERAJ

Kukës më 24.05.2022